

# STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 501

## EVIDENCA E AUDITIMIT – KONSIDERATA TË VEÇANTA PËR ZËRA TË ZGJEDHUR

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

### PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
<b>Hyrje</b>	
Objekti i këtij SNA-je	1
Hyrja në fuqi	2
<b>Objektivi</b>	3
<b>Kërkesat</b>	
Inventarët	4-8
Mosmarrëveshjet dhe Pretendimet	9-12
Informacioni i Segmentit	13
<b>Zbatimi dhe Materiale Të tjera Shpjeguese</b>	
Inventarët	A1-A16
Mosmarrëveshjet dhe Pretendimet	A17-A25
Informacioni i Segmentit	A26-A27

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 501 “Evidenca e Auditimit - Konsiderata të Veçanta për Zëra të Zgjedhur” duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 “Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”.

## Hyrje

### Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton konsiderata të veçanta të audituesit për të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në përputhje me SNA 330,<sup>1</sup> SNA 500<sup>2</sup> dhe SNA-të e tjera përkatëse, lidhur me disa aspekte të inventarëve, mosmarrveshjeve dhe pretendimeve që përfshijnë entitetin dhe informacionin e segmentit në auditimin e pasqyrave financiare.

### Hyrja në Fuqi

2. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

### Objektivi

3. Objektivi i audituesit është të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme lidhur me:
  - (a) Ekzistencën dhe kushtet e inventarëve;
  - (b) Plotësinë e mosmarrëveshjeve dhe pretendimeve që përfshijnë entitetin; dhe
  - (c) Paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shtesë të informacionit të segmentit në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

### Kërkesat

#### Inventarët

4. Në qoftë se inventaret janë materialë për pasqyrat financiare, audituesi merr evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme lidhur me ekzistencën dhe kushtet e inventarëve duke:
  - (a) Qënë i pranishëm në numërimin e inventarit fizik, përveç rasteve kur nuk është e mundur për të: (Ref: Para. A1-A3)
    - (i) Vlerësuar udhëzimet dhe procedurat e drejtimit për regjistrimin dhe kontrollin e rezultateve të numërimit të inventarëve fizikë të entitetit; (Ref: Para. A4)
    - (ii) Vëzhguar kryerjen e procedurave të numërimit të drejtimit; (Ref: Para. A5)

<sup>1</sup> SNA 330, *Përgjigja e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuar*.

<sup>2</sup> SNA 500, *Evidenca e Auditimit*.

- (iii) Inspektuar inventarët; dhe (Ref: Para. A6)
  - (iv) Kryer numërimet testuese; (Ref: Para. A7-A8)
- (b) Kryer procedurat e auditimit ndaj rregjistrimeve përfundimtare të inventarëve të entitetit për të përcaktuar nëse ato pasqyrojnë apo jo me saktësi rezultatet aktuale të numërimit të inventarëve.
5. Në qoftë se numërimi i inventarëve kryhet në një datë të ndryshme nga data e pasqyrave financiare, si shtesë të procedurave që kërkohen të kryhen nga paragrafi 4, audituesi kryen procedura auditimi për të marrë evidencë auditimi nëse ndryshimet në gjendjen e inventarëve nga data e numërimit deri në datën e pasqyrave financiare janë kontabilizuar siç duhet. (Ref: Para. A9-A11)
6. Në qoftë se audituesi nuk ka mundësi të jetë i pranishëm në numërimin e inventarit fizik për shkaqe të rrethanave të paparashikuara, audituesi duhet të bëjë ose të vëzhgojë disa numërimet fizike në një datë tjetër dhe të kryejë procedurat e auditimit ndaj transaksioneve ku ai ka qënë i pranishëm.
7. Në qoftë se prania në numërimin e inventarit fizik nuk është e mundur, audituesi kryen procedura alternative auditimi për të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme lidhur me ekzistencën dhe kushtet e inventarëve. Në qoftë se kjo nuk është e mundur për t'u bërë, audituesi modifikon opinionin në raportin e audituesit në përputhje me SNA 705 (i rishikuar).<sup>3</sup> (Ref: Para. A12-A14)
8. Në qoftë se gjëndja e inventarit nën ruajtjen dhe kontrollin e një pale të tretë është materiale për pasqyrat financiare, audituesi merr evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme lidhur me ekzistencën dhe kushtet e këtij inventari duke kryer një ose të dyja procedurat e mëposhtme:
- (a) Kërkon informacion nga pala e tretë për sasi dhe kushtet e inventarit të mbajtur gjëndje për llogari të entitetit. (Ref: Para. A15)
  - (b) Kryen inspektim ose procedura të tjera auditimi siç mund të jenë të përshtatshme në ato rrethana. (Ref: Para. A16)

### **Mosmarrëveshjet dhe Pretendimet**

9. Audituesi përgatit dhe kryen procedura auditimi për të identifikuar mosmarrëveshjet dhe pretendimet që përfshijnë entitetin të cilat mund të shkaktojnë rrezikun e anomalive materiale, përfshirë: (Ref: Para. A17-A19)
- (a) Pyet drejtimin dhe, kur është e nevojshme, të tjerë brenda entitetit, përfshirë këshilltarët e brendshëm juridikë;

---

<sup>3</sup> SNA 705, *Modifikimi i Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur*.

- (b) Rishikon proces-verbalet e mbledhjeve të atyre që janë ngarkuar me qeverisjen dhe korespondencën mes entitetit dhe këshilltarëve të tij të jashtëm juridikë; dhe
- (c) Rishikon llogaritë e shpenzimeve juridike. (Ref: Para. A20)

10. Në qoftë se audituesi vlerëson një rrezik për anomali materiale lidhur me mosmarrëveshje ose pretendime që janë të identifikuara, ose kur procedurat e auditimit të kryera tregojnë se mund të ekzistojnë edhe mosmarrëveshje ose pretendime të tjera materiale, si shtesë të procedurave të kërkuara nga SNA-të, audituesi kërkon komunikimin e drejtpërdrejtë me këshilltarin juridik të jashtëm të entitetit. Audituesi e bën këtë duke dërguar një letër me pyetje, të përgatitur nga drejtimi dhe të dërguar nga audituesi, duke i kërkuar këshilltarit të jashtëm juridik që të komunikojë drejtpërdrejt me audituesin. Në qoftë se ligji, rregulloret ose organizmat përkatës profesionalë të avokatisë e ndalojnë këshilltarin e jashtëm juridik për të komunikuar drejtpërdrejt me audituesin, audituesi kryen procedura auditimi të tjera alternative. (Ref: Para. A21-A25)

11. Në qoftë se:

- (a) drejtimi refuzon t'i japë leje audituesit për të komunikuar ose për t'u takuar me këshilltarin e jashtëm juridik të entitetit, ose këshilltari i jashtëm juridik i entitetit refuzon t'i përgjigjet përkatësisht letrës me pyetje, ose atë nuk e lejojnë të përgjigjet; dhe
- (b) audituesi nuk ka mundësi të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme duke kryer procedura auditimi alternative,

audituesi modifikon opinionin në raportin e audituesit në përputhje me SNA 705 (i rishikuar).

#### *Deklarimet me Shkrim*

12. Audituesi i kërkon drejtimin dhe, kur është e nevojshme, atyre që janë ngarkuar me qeverisjen të japin deklarime me shkrim se të gjitha mosmarrëveshjet dhe pretendimet e njohura aktuale dhe të mundëshme efektet e të cilave duhet të merren në konsideratë kur përgatiten pasqyrat financiare janë dhënë informacione shtesë tek audituesi dhe janë kontabilizuar dhe raportuar në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

#### **Informacioni i Segmentit**

13. Audituesi merr evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme lidhur me paraqitjen dhe raportimin e informacionit të segmentit në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar: (Ref: Para. A26)

- (a) Duke marrë njohuri për metodat e përdorura nga drejtimi në përcaktimin e informacionit të segmentit, dhe: (Ref: Para. A27)
- i. Duke vlerësuar nëse këto metoda kanë mundësi të rezultojnë në dhënien e informacionit shtesë në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar; dhe
  - ii. Kur është e përshtatshme, duke testuar zbatimin e këtyre metodave; dhe
- (b) Duke kryer procedura analitike ose procedura të tjera auditimi të përshtatshme për rrethanat.

\* \* \*

## **Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese**

### **Inventarët**

*Prania në Numërimin e Inventarëve Fizikë* (Ref: Para. 4(a))

- A1. Drejtimi si rregull përcakton procedura për kryerjen të paktën një herë në vit të inventarizimit fizik me qëllim që të shërbejë si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare ose për të verifikuar besueshmërinë e sistemit të inventarit kontabël të përhershëm.
- A2. Prania në numërimin e inventarëve fizikë përfshin:
- Inspektimin e inventarëve për t'u siguruar për ekzistencën e tij, për të vlerësuar kushtet e tij dhe për të kryer teste numërimi;
  - Vëzhgimin e përputhjes me udhëzimet e drejtimit dhe kryerjen e procedurave për regjistrimin dhe kontrollin e rezultateve të numërimit fizik të inventarëve; dhe
  - Marrjen e evidencës së auditimit për besueshmërinë e procedurave të numërimit të drejtimit.

Këto procedura mund të shërbejnë si teste të kontrolleve ose si procedura thelbësore në varësi të vlerësimit të rrezikut të audituesit, metodës së planifikuar dhe kryerjen e procedurave të veçanta.

- A3. Çështjet përkatëse në planifikimin e pranisë në inventarizimin fizik (ose në hartimin dhe kryerjen e procedurave të auditimit në përputhje me paragrafët 4-8 të këtij SNA-je), për shembull, përfshijnë:
- Rreziqet e anomalisë materiale që kanë lidhje me inventarin.

- Natyrën e kontrollit të brendshëm që ka lidhje me inventarin.
- Nëse janë vendosur procedura të përshtatshme dhe nëse janë hartuar e komunikuar udhëzimet e duhura për inventarizimin fizik.
- Afatet e inventarizimit fizik.
- Nëse entiteti ka një sistem të ndjekjes së vazhdueshme të inventarëve.
- Vendndodhjet në të cilat mbahen gjendjet e inventarëve, përfshirë materialitetin e inventereve dhe rrezikun e anomalive materiale në vendndodhje të ndryshme, për të vendosur se në cilën vendndodhje do të jetë më e përshtatshme prania. SNA 600<sup>4</sup> trajton përfshirjen e audituesve të tjerë dhe përkatësisht është e rëndësishme në qoftë se kjo përfshirje është lidhur me praninë në numërimin e inventarit fizik në një vendndodhje të largët.
- Në se është e nevojshme prania e një eksperti të audituesit. SNA 620<sup>5</sup> trajton përdorimin e ekspertit të audituesit për të ndihmuar audituesin për të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

#### Vlerësimi i Udhëzimeve të Drejtimit dhe Procedurat

A4. Çështjet përkatëse në vlerësimin e udhëzimeve dhe procedurave të drejtimit për regjistrimin dhe kontrollin e numërimit të inventarit fizik përfshijnë nëse ato i referohen apo jo, për shembull:

- Zbatimin e veprimtarive të përshtatshme të kontrollit, për shembull, mbledhjen e kartelave të përdorura për numërimin fizik të inventarëve, trajtimin kontabël të kartelave të inventarit fizik të papërdorur dhe procedurat e numërimit dhe rinumërimit.
- Identifikimin e saktë të gjendjeve të cilat janë në fazën e prodhimit në proces, gjendjeve me qarkullim të ngadalshëm, artikujve jashtë përdorimit ose të dëmtuar ose të gjendjeve që janë në pronësi të palëve të treta, për shembull, të mbajtura në ruajtje.
- Procedurat e zbatuara për të çmuar sasitë fizike, kur është e mundur, të tilla si ato që nevojiten për të çmuar sasitë fizike të një grumbulli qymyri.
- Kontrollit ndaj lëvizjeve të gjendjeve të inventarëve midis vendndodhjeve të ndryshme dhe të dërgimit e të marrjes së gjendjeve përpara dhe pas datës të ndarjes së periudhave.

<sup>4</sup> SNA 600, *Konsiderata të Veçanta – Auditimi i Pasqyrave Financiare të Grupit (përfshirë Punën e Audituesve të Entiteteve të Kontrolluara)*.

<sup>5</sup> SNA 620, *Përdorimi i Punës së Ekspertit të Audituesit*.

Vëzhgimi i Rezultateve të Procedurave të Numërimit të Drejtimit (Ref: Para. 4(a)(ii))

A5. Vëzhgimi i rezultateve të procedurave të numërimit të drejtimit, për shembull, ato që lidhen me kontrollet ndaj lëvizjeve të inventarëve përpara, gjatë dhe mbas numërimit, ndihmon audituesin të marrë evidencë auditimi se udhëzimet dhe procedurat e numërimit të drejtimit janë hartuar dhe vënë në zbatim në mënyrën e duhur. Më tej, audituesi merr kopje të informacioneve për ndarjen e periudhave, të tilla si detaje për lëvizjen e inventarëve, për të ndihmuar audituesin në kryerjen e procedurave të auditimit ndaj kontabilizimit të këtyre lëvizjeve në një datë të mëvonëshme.

Inspektimi i Inventarëve (Ref: Para. 4(a)(iii))

A6. Inspektimi i inventarëve kur është i pranishëm në numërimin e inventarit fizik e ndihmon audituesin të shqyrtojë ekzistencën e inventarëve (por jo domosdoshmërisht pronësinë e tij) dhe për të identifikuar, për shembull, inventarët jashtë përdorimit, të dëmtuara ose të vjetëruara.

Kryerja e Testeve të Numërimit (Ref: Para. 4(a)(iv))

A7. Kur kryhen teste të numërimeve, për shembull, duke krahasuar kartelat e artikujve të zgjedhur nga drejtimi për numërim me gjendjen fizike të inventarit dhe duke krahasuar artikujt e zgjedhur nga inventari fizik me kartelat e artikujve të rregjistruara nga drejtimi, jep evidencë auditimi mbi plotësinë dhe saktësinë e këtyre kartelave.

A8. Si shtesë të rregjistrimit të testeve të numërimit të audituesit, marrja e kopjeve të rregjistrimeve të numërimit të inventarit fizik të drejtimit ndihmon audituesin në kryerjen e procedurave të mëtejshme të auditimit për të përcaktuar nëse rregjistrimet e përgjithshme përfundimtare të inventarizimit pasqyrojnë apo jo në mënyrë të saktë rezultatet e numërimit të inventarëve.

*Numërimet e Inventarëve Fizikë të Kryer jo në Datën e Pasqyrave Financiare* (Ref: Para. 5)

A9. Për shkaqe praktike, inventarizimi fizik mund të kryhet në një datë, ose data të ndryshme nga data e pasqyrave financiare. Kjo mund të bëhet pavarësisht nëse drejtimi ka llogaritur sasinë e inventarëve nga numërimi i inventarit fizik vjetor apo nga sistemi i inventarizimit kontabël të vazhdueshëm. Në të dyja rastet, efektiviteti i hartimit, vënies në zbatim dhe mbajtjes së kontrolleve ndaj ndryshimeve në gjendjet e inventarëve përcaktohet nëse kryerja e numërimit të inventarit fizik në një datë, ose data të ndryshme nga data e pasqyrave financiare është e përshtatshme apo jo për qëllimet e auditimit. SNA 330 përcakton kërkesa dhe jep udhëzime për procedurat thelbësore që kryhen në një datë të ndërmjetme.<sup>6</sup>

<sup>6</sup> SNA 330, paragrafët 22-23.

- A10. Kur entiteti operon me një sistem inventarizimi të përhershëm, drejtimi duhet të kryejë numërimet fizike ose teste të tjera për t'u siguruar për besueshmërinë e informacionit për sasi të inventarit që përfshihen në rregjistrimet e sistemit të inventarizimit të përhershëm. Në disa raste, drejtimi ose audituesi mund të identifikojnë diferenca mes inventarizimit të përhershëm kontabël dhe sasive aktuale të inventarit fizik; kjo mund të tregojë se kontrollet ndaj ndryshimeve në gjendjet e inventarëve nuk funksionojnë me efektivitetin e duhur.
- A11. Çështjet përkatëse për t'u marrë në konsideratë kur hartohen procedurat e auditimit për të marrë evidencë auditimi nëse janë rregjistruar siç duhet ndryshimet në shumat e inventarëve nga data, ose datat e numërimit deri në rregjistrimet përfundimtare të inventarëve, përfshijnë:
- Nëse janë saktësuar përkatësisht rregjistrimet e inventarizimit kontabël të përhershëm.
  - Besueshmëria e rregjistrimeve të sistemit të inventarizimit kontabël të përhershëm.
  - Arsyet për diferencat e konsiderueshme mes informacionit të marrë gjatë inventarizimit fizik dhe rregjistrimeve të inventarizimit kontabël.

*Prania në Numërimin e Inventarit Fizik Është e Pamundur* (Ref: Para. 7)

- A12. Në disa raste, prania në numërimin e inventarit fizik mund të jetë e pamundur. Kjo mund të shkaktohet nga faktorë të tillë si natyra dhe vendndodhja e inventarëve, për shembull, kur inventari mbahet në vendndodhje që janë kërcënuese për sigurinë e audituesit. Çështja e pamundësisë në përgjithësi e audituesit, gjithsesi, nuk është e mjaftueshme për të justifikuar vendimin e audituesit që prania nuk është e mundur. Më tej, siç sqarohet në SNA 200,<sup>7</sup> çështja e vështirësisë, kohës, ose kostos që shkaktojnë mospraninë nuk është në vetvete një justifikim i vlefshëm për audituesin të mos kryejë procedurën e auditimit për të cilën nuk ka asnjë alternativë tjetër ose të kënaqet me evidencën e auditimit që është më pak bindëse.
- A13. Në disa raste kur prania nuk është e mundur, procedura alternative auditimi mund të japin evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për ekzistencën dhe kushtet e inventarit, për shembull, inspektimi i dokumenteve të shitjeve pasuese të artikujve të veçantë të inventarit të marrë ose të blerë para numërimit të inventarit fizik.
- A14. Në raste të tjera, megjithatë, nuk është e mundur që të merret evidencë auditimi i mjaftueshme dhe e përshtatshme lidhur me ekzistencën dhe kushtet e inventarit duke kryer procedura auditimi alternative. Në këto raste, SNA 705 (i rishikuar) kërkon që

<sup>7</sup> SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e Auditimit në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi A48.



audituesi të modifikojë opinionin në raportin e auditimit si rezultat i kufizimit të objektit.<sup>8</sup>

*Inventari në Ruajtje dhe nën Kontrollin e një Pale të Tretë*

Konfirmimi (Ref: Para. 8(a))

A15. SNA 505<sup>9</sup> parashikon kërkesa dhe jep udhëzime për kryerjen e procedurave të konfirmimeve.

Procedura të Tjera Auditimi (Ref: Para. 8(b))

A16. Në varësi të rrethanave, për shembull, kur informacioni i marrë nga një palë e tretë ngre dyshime për integritetin dhe objektivitetin e tij, audituesi duhet të marrë në konsideratë si të përshtatshme të kryejë procedura të tjera auditimi në vend të, ose si shtesë të, konfirmimeve nga pala e tretë. Shembuj të procedurave të tjera të auditimit përfshijnë:

- Duke qënë i pranishëm, ose duke angazhuar një auditues tjetër që të jetë i pranishëm, në numërimin e inventarit fizik të palës së tretë, nëse është e mundur.
- Marrjen e raportit të audituesit tjetër, ose raportit të audituesit me kontratë të posaçme shërbimi, për të shqyrtuar përkatësinë e kontrollit të brendshëm të palës së tretë dhe për t'u siguruar se inventari është numëruar dhe ruhet siç duhet.
- Inspektimi i dokumentacionit lidhur me inventarin e mbajtur nga palët e treta, për shembull, fletë-hyrjet e magazinës.
- Duke kërkuar konfirmime nga palët të tjera kur ky inventar është vendosur si kolateral.

Mosmarrëveshjet dhe Pretendimet

*Plotësia e Mosmarrëveshjeve dhe Pretendimeve* (Ref: Para. 9)

A17. Mosmarrëveshjet dhe pretendimet që lidhen me entitetin mund të kenë efekt material në pasqyrat financiare dhe për këtë arsye duhet të kërkohet të jepen informacione shtesë dhe të kontabilizohen në pasqyrat financiare.

A18. Si shtesë të procedurave të identifikuar në paragrafin 9, procedura të tjera përkatëse përfshijnë, për shembull, përdorimin e informacionit të marrë nga procedurat e vlerësimit të rrezikut të kryera si pjesë e marrjes së njohurive për entitetin dhe

---

<sup>8</sup> SNA 705 (i rishikuar), paragrafi 13.

<sup>9</sup> SNA 505, *Konfirmimet nga të Tretët*.

mjedisin e tij për të ndihmuar audituesin të marrë djepi për mosmarrëveshjet dhe pretendimet që lidhen me entitetin.

- A19. Evidenca e auditimit e marrë për qëllimet e identifikimit të mosmarrëveshjeve dhe pretendimeve që shkaktojnë një rrezik të anomalisë materiale gjithashtu mund të japin evidencë auditimi lidhur me konsiderata të tjera përkatëse, të tilla si vlerësimi apo matja, që lidhen me mosmarrëveshjet dhe pretendimet. SNA 540<sup>10</sup> parashikon kërkesa dhe jep udhëzimet e duhura për audituesin që të marrë në konsideratë mosmarrëveshjet dhe pretendimet që kërkojnë çmuarjet kontabël apo dhënien e informacionit përkatës në pasqyrat financiare.

Rishikimi i Llogarive të Shpenzimeve Juridike (Ref: Para. 9(c))

- A20. Në varësi të rrethanave, audituesi mund ta gjykojë të përshtatshme të ekzaminojë dukomentat e burimit të informacionit përkatës, të tilla si faturat për shpenzimet juridike, si pjesë të rishikimit të audituesit të llogarive të shpenzimeve juridike.

*Komunikime me Këshilltarët e Jashtëm Juridikë të Entitetit* (Ref: Para. 10-11)

- A21. Komunikimi i drejtpërdrejtë me këshilltarët e jashtëm juridikë të entitetit e ndihmon audituesin të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme nëse njihen nga drejtimi mosmarrëveshjet dhe pretendimet materiale të mundëshme dhe çmuarjet nga drejtimi të efekteve financiare, përfshirë kostot, janë të arsyeshme.
- A22. Në disa raste, audituesi duhet të kërkojë komunikim të drejtpërdrejtë me këshilltarët e jashtëm juridikë të entitetit nëpërmjet një letre me pyetje të përgjithshme. Për këtë qëllim, një letër me pyetje të përgjithëshme i kërkon këshilltarëve të jashtëm juridikë të entitetit që të informojnë audituesin për ndonjë mosmarrëveshje dhe pretendim që këshilltari ka djepi, sëbashku me një vlerësim të rezultateve të mosmarrëveshjeve dhe pretendimeve dhe një çmuarje të efekteve financiare, përfshirë edhe kostot.
- A23. Në qoftë se konsiderohet se këshilltari i jashtëm juridik i entitetit nuk do t'i përgjigjet përkatësisht letrës me pyetje të përgjithshme, për shembull, në qoftë se organizmi profesional të cilit i përket këshilltari juridik i jashtëm e ndalon përgjigjen për këtë letër, audituesi duhet të kërkojë komunikimin e drejtpërdrejtë nëpërmjet një letre me pyetje të veçanta. Për këtë qëllim, letra e pyetjeve të veçanta përfshin:

- Një listë të mosmarrëveshjeve dhe pretendimeve;
- Kur është e disponueshme, vlerësimi i drejtitimit për rezultatet e secilit prej mosmarrëveshjeve dhe pretendimeve të identifikuar dhe çmuarjen e tij të efekteve financiare, duke përfshirë kostot e tyre;

<sup>10</sup> SNA 540, *Auditimi i Çmuarjeve Kontabël, Përfshirë Çmuarjet Kontabël të Vlerës se Drejtë si dhe Shpjegimet Përkatëse.*

- Një kërkesë që këshilltari i jashtëm juridik i entitetit të konfirmojë llogjikën e vlerësimeve të drejtimit dhe t'i japë audituesit informacione të mëtejshme në qoftë se lista konsiderohet nga këshilltari i jashtëm juridik i entitetit se është jo e plotë ose jo e saktë.

A24. Në rrethana të caktuara, audituesi gjithashtu mund ta gjykojë të nevojshme të takohet me këshilltarin juridik të jashtëm të entitetit për të diskutuar rezultatet e mundshme të mosmarrëveshjeve apo pretendimeve. Ky mund të jetë rasti kur, për shembull:

- Audituesi vendos se çështja është një rrezik i konsiderueshëm.
- Çështja është komplekse.
- Ka kontradikta mes drejtimit dhe këshilltarit juridik të jashtëm të entitetit.

Zakonisht, këto takime kërkojnë marrjen leje nga drejtimi dhe mbahen në praninë e përfaqësuesit të drejtimit.

A25. Në përputhje me SNA 700 (i rishikuar),<sup>11</sup> audituesit i kërkohet të datojë raportin e audituesit jo më parë se data në të cilën audituesi ka marrë evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme mbi të cilën bazon opinionin e audituesit mbi pasqyrat financiare. Evidenca e auditimit rreth gjendjes së mosmarrëveshjeve dhe pretendimeve deri në datën e raportit të audituesit duhet të merret duke pyetur drejtimi, përfshirë këshilltarët juridikë të brendshëm, përgjegjës për të trajtuar çështjet përkatëse. Në disa raste, audituesit i duhet të marrë informacion të azhurnuar nga këshilltari juridik i jashtëm i entitetit.

### **Informacioni i Segmentit (Ref: Para. 13)**

A26. Në varësi të kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar, entitetit mund t'i kërkohet ose t'i lejohet të japë informacione shtesë për segmentin në pasqyrat financiare. Përgjegjësia e audituesit lidhur me paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shtesë të segmentit është në lidhje me pasqyrat financiare të marra si një e tërë. Përkatësisht, audituesit nuk i kërkohet të kryejë procedura auditimi që do të ishin të nevojshme për të shprehur një opinion mbi informacionin e segmentit të paraqitur mbi baza më vete.

### *Njohja e Metodave të Përdorura nga Drejtimi (Ref: Para. 13(a))*

A27. Në varësi të rrethanave, shembull i çështjeve që janë të rëndësishme kur merret njohje e metodave të përdorura nga drejtimi për të përcaktuar informacionin e segmentit dhe nëse këto metoda ka mundësi të rezultojnë në dhënien e informacioneve shtesë në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar përfshijnë:

---

<sup>11</sup> SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare*, paragrafi 49.

- Shitjet, transferimet dhe shpenzimet mes segmenteve dhe eliminimin e shumave brenda segmentit.
- Krahasimet me buxhetet dhe rezultatet e tjera të pritëshme, për shembull, fitimi bruto (operacional) si përqindje ndaj shitjeve.
- Shpërndarja e aktiveve dhe kostove midis segmenteve.
- Njëtrajtshmëria me periudhat e mëparshme dhe përshtatshmëria e dhënies së informacioneve shtesë në lidhje me mospërputhjet.